



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Datë 11/09/2012

NJOFTIM PËR SHTYP

Mbi disa ndryshime në rregulloren e caktimit të shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës me qëllim lehtësimin e biznesit të vogël dhe të mesëm, mbështetur në ndryshimet e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka vendosur të ulë shpenzimet për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës.

Amendimet e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, lidhur me përqëndrimet kishin për qëllim rritjen e rolit kontrollues të Autoritetit të Konkurrencës për një mbikëqyrje më efikase dhe më të plotë të ndryshimeve strukturore në tregje për të siguruar mirë funksionimin e tyre.

Me “përqëndrim” kuptohet ndryshimi i kontrollit si pasojë e marrjes së paketës kontrolluese të kuotave nga një ose disa ndërmarrje (persona), bashkimi i dy ose më shumë ndërmarrjeve apo krijimi i një ndërmarrje të përbashkët nga dy ndërmarrje aktive në treg. Këto transaksione që të kenë vlefshmëri juridike duhet të njoftohen brenda 30 ditëve dhe të autorizohen nga Komisioni i Konkurrencës.

Ulja e pragut të xhiros vjetore të ndërmarrjeve që janë objekt autorizimit, sipas amendimeve të reja të ligjit, sollën në vëmendjen e Komisionit të Konkurrencës zbatimin e parimit të proporcionalitetit për kostot administrative që lidhen me procedurat e njoftimit dhe të autorizimit të përqëndrimeve.

Më konkretisht, në Rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve dhe ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”, për ndërmarrjet e vogla, që përfitojnë kontrollin dhe që në tregun e brendshëm kanë xhiro vjetore nga 200 milionë lekë deri në 1 miliardë lekë, tërheqja e “Formularit të njoftimit të përqëndrimit” bëhet kundrejt pagesës 7.500 Lekë. Ndërkohë që për ndërmarrjet me xhiro më shumë se 1 miliardë lekë tarifa e tërheqjes së formularit të mbetet e pandryshuar, 15 mijë lekë. Gjithashtu, edhe për tërheqjen e autorizimit “Për realizimin e përqëndrimit”, pagesa bëhet 250 mijë Lekë për ndërmarrjet që përfitojnë kontrollin dhe që në tregun e brendshëm kanë xhiro vjetore nga 200 milionë lekë deri në 1 miliardë lekë. Ndërkohë që marrja e autorizimit për realizimin e përqëndrimit për ndërmarrjet me xhiro vjetore më shumë se 1 miliardë lekë tarifa mbetet e pandryshueshme, 500 mijë lekë.